



Termet e Referencës

Titulli i Projektit: EJA: Environmental Justice in Albania

Numri i Referencës: IPA III/2023/452-010

Titulli i Pozicionit: Drejtues i Ekipit për Koordinimin e punës së grupeve që do zhvillojnë 3 kapitujt e projektit dhe Konsolidimin e Raportit "Green Justice and Grey Crime in Albania"

Afati i Aplikimit: 28 mars 2025

Objekti i punës: REC Shqipëri kërkon të kontraktojë një ekspert për pozicionin e punës "Drejtues Ekipi", që të marrë përsipër punën për drejtimin e grupeve të ekspertëve që do të angazhohen në zhvillimin e kapitujve të Raportit "Cap and Gap: Grey Crime and Green Justice in Albania" dhe konsolidimin e mëtejshëm dhe përpunimin e raportit në një material përfundimtar.

1. Konteksti i Thirrjes

"EJA: Environmental Justice in Albania", është një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian, që synon të trajtojë dhe nxisë aksesin e të drejtave mjedisore në institucionet shqiptare të ligj-zbatimit dhe atyre që ofrojnë drejtësi, përmes shqyrtimit të ecurisë së dëmeve në mjedis në secilen prej këtyre hallkave, rritjes së kapaciteteve të nëpunësve ligjorë pranë institucioneve përkatëse dhe forcimit të pjesëmarrjes së mediave dhe publikut në promovimin e drejtësisë mjedisore. Një prej produkteve kryesore të këtij projekti është zhvillimi i një raporti diagnostik, i titulluar: "Cap & Gap Report: Green Justice and Grey Crime in Albania". Synimi i tij është adresimi përmes një analize që do të gjenerojë të dhëna sasiore dhe cilësore, për sa i përket reagimit të institucioneve, apo mënyrës si trajtohen kundërvajtjet mjedisore; identifikimi i hendeqeve në një fushë kaq komplekse pune dhe ofrimi i rekomandimeve konkrete për përmirësim. Raporti do të marrë në shqyrtim punën e strukturave ligj-zbatuese dhe atyre të drejtësisë që kanë juridiksion mbi qarqet Tiranë, Elbasan dhe Korçë, për çështje të verifikuara në këto qarqe ose çështje/vepra që pavarësisht se ku konstatohet se kanë ndodhur, janë iniciuar për nga aspekti i denoncimit, procedimit apo gjykimit (varësisht nga hallka që po shqyrtohet: policia, prokuroria apo gjykata) në institucionet e këtyre qarqeve.

Përmbajtja e raportit do të jetë e organizuar në disa kapituj, ku secili prej tyre do të mbulojë aspekte të caktuara, të lidhura me punën në nivel hallkash, të institucioneve ligj-zbatuese dhe atyre të drejtësisë. Puna për zhvillimin e kapitujve do të kryhet nga grupe të dedikuara ekspertësh të specializuar, në fushat e gazetarisë investigative dhe të kuadrit përkatës ligjor, në nivel vendi.

Më konkretisht, kapitujt e raportit do të jenë:

Kapitulli i Policisë: Roli i Policisë së Shtetit në mbrojtje të mjedisit në Shqipëri

Grupi i ekspertëve të angazhuar në kapitullin e policisë do të analizojë rolin e agjencive të zbatimit të ligjit në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Studimi do të fokusohet në punën e Policisë së Shtetit, Policisë Bashkiake dhe Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

Analiza do të thellohet në mënyrën se si këto institucione parandalojnë dhe hetojnë kundërvajtjet mjedisore dhe si bashkëpunohet me agjencitë e mjedisit dhe ekspertizën mjedisore. Studimi do të shqyrtojë rastet e regjistruara, metodat e përdorura dhe efektivitetin e ndërhyrjeve policore, duke u bazuar në të dhënat nga institucionet dhe agjencitë përkatëse.

Kapitulli i Prokurorisë: Roli i Prokurorisë në investigimin e krimit mjedisor në Shqipëri



Grupi i ekspertëve të angazhuar për kapitullin e prokurorisë do të marrë në shqyrtim itinerarin dhe ecurinë e çështjeve mjedisore në institucionin e prokurorisë. Studimi do të përqendrohet në analizimin e procedurave penale, mbledhjen e të dhënave dhe identifikimin e llojeve të ndryshme të krimeve mjedisore në Shqipëri.

Analiza do të përfshijë shqyrtimin e mënyrës se si prokuroria regjistron, heton dhe procedon rastet mjedisore, duke përfshirë mbledhjen e provave, caktimin e ekspertëve dhe ndjekjen e çështjeve në gjykatë (kjo e fundit lidhur me dy rezultatet e mundshme: ose shuarja e çështjes, ose përcjellja e saj në hallkën e mëtejshme të gjykimit). Pritja është për një punë që do të duhet të mbështetet në të dhënat e agjencive, ministritë përkatëse dhe institucionet e tjera të specializuara, për të krijuar një panoramë të plotë të situatës.

Kapitulli i Gjykatës: Roli i Gjykatave në garantimin e drejtësisë mjedisore në Shqipëri

Grupi i ekspertëve të angazhuar në punën për kapitullin e Gjykatës, do të përqendrohet në filtrimin e çështjeve të lidhura me mjedisin dhe përvijojë përfundime në lidhje me shkallën e ndëshkueshmërisë së këtyre çështjeve.

Fokusi i studimit do të jenë çështjet e paraqitura në Gjykatën e Apelit, Juridiksioni i Përgjithshëm, ndërkohë që metodologjia do të përfshijë konsultimin e sistemeve elektronike, dokumentacionit gjyqësor dhe realizimin e takimeve me autoritetet përkatëse. Në njohje të vëshitësisë që lidhet me identifikimin e çështjeve të natyrës mjedisore thjesht përmes çelësave filtrues të motorëve të kërkimit të faqeve me qasje publike, rekomandim është që gjatë kërkimit të përdoren aktorët e mundshëm që ka gjasa të jenë palë kyçe (paditës ose të paditur) në çështje të natyrës mjedisore, të tillë si Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), si dhe emra të përveçëm subjektsh private që janë përfshirë në vepra të mëdha infrastrukturore me ndikim të konsiderueshëm në mjedis, të tilla si ndërtimi apo mirëmbajtja e hidrocentraleve, rrugëve, porteve, HEC-eve, TEC-eve, shpimi dhe nxjerrja e naftës, etj.

Raporti do të përmbajë edhe një kapitull në lidhje me rolin e mediave në denoncimin dhe investigimin e krimit mjedisor, i cili do të do të hartohet nga partneri i REC Shqipëri në këtë projekt, Balkan Investigative Regional Network (BIRN) in Albania.

Drejtuesi i Ekipit do të jetë përgjegjës për të koordinuar punën, kontribuar me të dhëna suplementare, pasuruar dhe përmirësuar punën e grupeve të ekspertëve, duke siguruar që raporti përfundimtar të jetë koherent dhe i plotë, dhe të përfshijë kontributet e të gjitha grupeve.

Në shtojcën shoqëruese gjenden ToR të detyrës, për secilin prej kapitujve të cilësuar më lart, veçmas.

2. Objektivat e Detyrës

- Të garantojë që procesi i hartimit të raporteve për Policinë, Prokurorinë dhe Gjykatat ndjek një qasje të unifikuar, metodologjikisht të saktë dhe të bazuar në evidenca;
- Të sigurojë që grupet e ekspertëve të punojnë në sinkronizim dhe të kontribuojnë në mënyrë efektive dhe sistematike në analizën dhe rekomandimet përfundimtare;
- Të sigurojë që çdo kapitull kontribuon në mënyrë të qartë dhe të argumentuar në strukturën e përgjithshme të raportit “Green Justice and Grey Crime in Albania”;
- Të propozojë mekanizma për matjen e progresit dhe sigurimin e zbatimit të rekomandimeve;



3. Përgjegjësitë Kryesore

Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të stafit të projektit, Drejtuesi i Ekipit do të ndërmarrë detyrat e mëposhtme:

- Të mbajë një seancë të parë informuese dhe trajnuese me grupet e ekspertëve për të prezantuar formatin dhe metodologjinë e raportit;
- Të ofrojë udhëzime mbi zhargonin dhe terminologjinë që duhet të përdoret në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë raportin;
- Të diskutojë elementet e përbashkëta që duhet të reflektohen në punën individuale të secilit grup;
- Të sigurojë që grupet e ekspertëve për Policinë, Prokurorinë dhe Gjykatat ndjekin metodologjinë e përcaktuar;
- Të zhvillojë një strukturë të detajuar për kapitujt, duke përfshirë hyrjen, qasjen metodologjike dhe burimet e shqyrtuara/mbledhura, analizën kryesore të mbështetur nga infografikë që pasqyrojnë panoramën e ecuresë institucionale, rekomandimet përfundimtare, implikimet e mëtejshme (nëse do të ketë), dhe referencat kyçe;
- Të sigurojë që grupet e ekspertëve për Policinë, Prokurorinë dhe Gjykatat ndjekin metodologjinë e përcaktuar;
- Të ofrojë udhëzime të qarta për mënyrën se si të dhënat duhet të prezantohen dhe analizohen;
- Të mbikëqyrë punën e secilit grup për të garantuar përputhshmërinë e të dhënave dhe analizave;
- Të propozojë dhe zbatojë një kalendar të rregullt takimesh me grupet e ekspertëve dhe REC Shqipëri;
- Të mbajë seanca periodike raportimi për të ndjekur progresin e punës dhe për të zgjidhur sfidat e mundshme;
- Të sigurojë që secili kapitull kontribuon në analizën dhe rekomandimet e përgjithshme;
- Të sigurojë koordinimin efektiv midis grupeve të ekspertëve dhe ekipit të projektit;
- Të jetë pikë kyçe e kontaktit për sqarime dhe harmonizim të analizave ndërmjet kapitujve;
- Të rishikojë produktet e punës sipas secilit kapitull dhe të integrojë përmbajtjen në një raport përfundimtar, si dhe zhvillojë gjetje të integruara të raportit në tërësi;
- Të shohë angazhimin e tij të shtrirë edhe në veprimtari trajnimi më OSHC-të, përfaqësuesit e mediave, si dhe pjesë të grupimit që do ‘institucionalizojë’ puna për zhvillimin e raportit, nën emërtesën ‘Korpusi e Gazetarave & Aktivistëve Kundër Krimet Mjedisor’

Drejtuuesi i Ekipit do të jetë përgjegjës për produktet e mëposhtme:

- Plan Pune i detajuar për zhvillimin e raportit “Green Justice and Grey Crime in Albania”.
- Procesverbalet e takimeve me grupet e ekspertëve, shoqëruar me regjistrime të takimeve online;
- Draftet e kapitujve të rishikuara dhe të finalizuara.
- Raporti i plotë dhe i finalizuar “Green Justice and Grey Crime in Albania”, i gatshëm për publikim.
- Raporte të rregullta të progresit drejtuar stafit të projektit.
- Prezantim/e, në rastet e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupimit në aktivitetet e projektit;



5. Kualifikimet dhe Përvoja e Kërkuar

Arsimi: Diplomë universitare e avancuar (Master ose më e lartë) në Drejtësi

Përvoja Profesionale:

- Minimumi 7 vite përvojë në projekte ligjore, drejtësi mjedisore ose qeverisje.
- Përvojë e demonstruar në drejtimin e ekipeve ndërdisiplinore dhe koordinimin e ekspertëve të shumtë.
- Njohuri të mira mbi legjislacionin mjedisor, praktikat gjyqësore dhe strukturat institucionale të Shqipërisë.

Aftësitë dhe Kompetencat:

- Aftësi të shkëlqyera organizative dhe të menaxhimit të kohës.
- Aftësi të forta ndërpersonale dhe komunikimi për të lehtësuar dialogun midis palëve të ndryshme të interesit.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi me shkrim dhe verbal në anglisht dhe shqip.
- Aftësi për të punuar në kushte presioni dhe për të përmbushur afate të ngushta.
- Njohuri të mira të paketës Microsoft Office.

6. Raportimi dhe Mbikëqyrja

Drejtuesi i Ekipit do të raportojë drejtpërdrejt te Menaxheri i Projektit “EJA” dhe do të marrë pjesë në takime të projektit sipas nevojës.

7. Kohëzgjatja e Detyrës

Detyra do të fillojë menjëherë pas përzgjedhjes së kandidatit dhe do të përfundojë me dorëzimin e raportit final “Green Justice and Grey Crime in Albania”.

8. Procedura e Aplikimit

Kandidatët e interesuar ftohen të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme në adresat projects@recshqiperi.org dhe recshqiperi@gmail.com deri më 28 Shkurt 2025:

- **Curriculum Vitae (CV)** që përshkruan kualifikimet dhe përvojën relevante.
- **Plani i Propozuar i Punës** që tregon disponueshmërinë, metodologjinë dhe një afat kohor paraprak për detyrën.
- **Letër Motivimi** që shpjegon qasjen e aplikantit ndaj koordinimit dhe konsolidimit të raporteve me shumë autorë.
- **Propozim Financiar** që të cilesojë tarifen ditore të punës.

9. Kushtet e Pagesës

Pagesa do të kryhet sipas dispozitave përkatëse në kontratën që do të lidhet me ekspertin, kurrsesi jo përpara dorëzimit të setit të parë të output-eve të pritura.

10. Konfidencialiteti dhe Pronësia Intellektuale

Të gjitha raportet, të dhënat dhe materialet e prodhuara nga Drejtuesi i Ekipit në kuadër të këtij kontrakti mbeten pronësi e REC Albania, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe në kontratë. Drejtuesi i Ekipit duhet të ruajë konfidencialitetin e të gjitha informacioneve lidhur me projektin gjatë dhe pas përfundimit të detyrës.